

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2658 / Prot.

3

Tiranë, më 27.09.2022

VENDIM

Nr. 57, datë 27.09.2022

“PËR NJË KORRIGJIM GABIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR.8 DATË 26.01.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË PËRJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 DHE STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË INTEGRUAR, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 29.03.2017, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 1423/1 prot., datë 29.06.2022, “Kërkese për një ndryshim në vendimet e bordit nr.6 dhe 8 datë 26.01.2022”, në mbledhjen e datës 27.09.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë korrigjimin e gabimit në vendimin nr.8 datë 26.01.2022 me objekt “Për miratimin e listës së studentëve që përfitojnë përjashtim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2021-2022 dhe studiojnë në një program studimi të ciklit të parë dhe program studimi të integruar, në Universitetin e Mjekësisë”, duke korriguar gabimin e emrit të studentit Desara Almir Hyka me emrin e studentit Desara Ferdinand Hysko.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI



ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT VZEIRAJ